



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:058388

Datë: 04.03.2025

Numri i dokumentit: 07065657

KI.nr.3/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Divizioni për Investitor të Huaj, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësve: 1. “MaxCapital” SH.A., me NUI:810801044, me seli në Prishtinë, rruga “Sejdi Kryeziu”, Nr.19, Pejton, 2. “Science Soft” SH.P.K., me NUI:810873043, me seli në Prishtinë, “Zekria Cana” Nr.3, dhe 3. “Club Gold” SH.P.K., me NUI:810083767, të cilët i përfaqëson shoqëria Deloitte Kosova SH.P.K., përmes avokatit Ardian Rexha, kundër të paditurit Republika e Kosovës - Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilin sipas autorizimin e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 42,811,361.80 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 20.02.2025, në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datë 04.03.2025 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve 1. “MaxCapital” SH.A., 2.“Science Soft” SH.P.K., dhe 3. “Club Gold” SH.P.K., dhe DETYROHET i padituri Republika e Kosovës - Qeveria e Republikës së Kosovës, që në emër të kompensimit të dëmit real në formën e fitimit të munguar për shkak të revokimit të licencave, paditësve t’ua paguaj shumat si në vijim:
- i. Paditësit 1. “MaxCapital” SH.A., në emër të kompensimit të dëmit në formën e fitimit të munguar, të pësuar si pasojë e revokimit të licencës nr.37/2017, të datës 06.06.2017, për ushtrimin e veprimtarisë “baste sportive”, për periudhën prej 10.05.2019 deri më 05.06.2019, t’ia paguaj shumën prej 37,641.81 € (tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e katërdhjetë e një euro e tetëdhjetë e një cent), me kamatë ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%, duke filluar nga data e

parashtrimit të padisë 28.05.2020, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

ii. Paditësit 2. “Science Soft” SH.P.K., në emër të kompensimit të dëmit në formën e fitimit të munguar, të pësuar si pasojë e revokimit të licencës nr.24/2017, të datës 02.11.2017, për ushtrimin e veprimtarisë “baste sportive”, për periudhën prej 10.05.2019 deri më 01.11.2019, shumën prej 287,500.45 € (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind euro e katërdhjetë e pesë cent), me kamatë ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 28.05.2020, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

iii. Paditësit 3. “Club Gold” SH.P.K., në emër të kompensimit të dëmit në formën e fitimit të munguar, të pësuar si pasojë e revokimit të licencës nr.04/2018, të datës 27.09.2018, për ushtrimin e veprimtarisë “automateve në klube të veçanta”, për periudhën prej 10.05.2019 deri më 26.09.2020, shumën prej 1,086,608.33 € (një milion e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tetë euro e tridhjetë e tre cent), me kamatë ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 28.05.2020, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve 1. “MaxCapital” SH.A., 2. “Science Soft” SH.P.K., dhe 3. “Club Gold” SH.P.K., mbi shumat e aprovuara në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë:

i. Paditësit 1. “MaxCapital” SH.A., i refuzohet kërkesa me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit në formën e fitimit të munguar, të pësuar si pasojë e revokimit të licencës nr.37/2017, të datës 06.06.2017, për ushtrimin e veprimtarisë “baste sportive”, për periudhën nga data 06.06.2019 deri më 05.06.2021, në shumën prej 1,098,295.13 €, si dhe kërkesa për kamatë ligjore mbi shumën e aprovuar të kamatës.

ii. Paditësit 2. “Science Soft” SH.P.K., i refuzohet kërkesa me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit në formën e fitimit të munguar, të pësuar si pasojë e

revokimit të licencës nr.24/2017, të datës 02.11.2017, për ushtrimin e veprimtarisë “baste sportive”, për periudhën nga data 02.11.2019 deri më 01.11.2021, në shumën prej 1,150,001.79 €, si dhe kërkesa për kamatë ligjore mbi shumën e aprovuar të kamatës.

- iii. Paditësit 3. “Club Gold” SH.P.K., i refuzohet kërkesa me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit në formën e fitimit të munguar, të pësuar si pasojë e revokimit të licencës nr.04/2018, të datës 27.09.2018, për ushtrimin e veprimtarisë “automateve në klube të veçanta”, për periudhën nga data 27.09.2020 deri më 26.09.2022, në shumën prej 32,779,890.70 €, si dhe kërkesa për kamatë ligjore mbi shumën e aprovuar të kamatës.

- III. DETYROHET i padituri Republika e Kosovës - Qeveria e Republikës së Kosovës, që në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësit “MaxCapital” SH.A., t’ia paguaj shumën prej 5,528.10 € (pesë mijë e pesëqind e njëzet e tetë euro e dhjetë cent)

A r s y e t i m

Çështja gjyqësore

Paditësit 1. “MaxCapital” SH.A., 2. “Science Soft” SH.P.K., 3. “Club Gold” SH.P.K., përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 28.05.2020, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, kanë paraqitur padi për kompensim dëmi kundër të paditurve 1. Republika e Kosovës dhe 2. Qeveria e Republikës, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohen të paditurit që në mënyrë solidare, paditësve të ua kompensojnë shumat si në vijim: 1. paditësit të parë “MaxCapital” SH.A., në emër të shpronësimit të paligjshëm të licencës nr.37/2017, e datës 06.06.2017, për ushtrimin e veprimtarisë “baste sportive”, t’ia kompensojnë dëmin material dhe fitimin e munguar deri më datë 05.06.2021, me kamatë ligjore prej 8% nga data efektive e shpronësimit 10.05.2019 deri në pagesën definitive; 2. paditësit të dytë “Science Soft” SH.P.K., në emër të shpronësimit të paligjshëm të licencës nr.24/2017, e datës 02.11.2017, për ushtrimin e veprimtarisë “baste sportive”, t’ia kompensojnë dëmin material dhe fitimin e munguar deri më datë 01.11.2021, me kamatë ligjore prej 8% nga data efektive e shpronësimit 10.05.2019 deri në pagesën definitive dhe 3. paditësit të tretë “Club Gold” SH.P.K., në emër të shpronësimit të paligjshëm të licencës nr.04/2018, e datës 27.09.2018, për ushtrimin e veprimtarisë “automateve në klube të veçanta”,

t'ia kompensojnë dëmin material dhe fitimin e munguar deri më datë 26.09.2022, me kamatë ligjore prej 8% nga data efektive e shpronësimit 10.05.2019 deri në pagesën definitive, si dhe të detyrohen të paditurit që paditësve të ua kompensojnë shpenzimet e procedurës kontestimore.

Me parashtresën e dorëzuar në seancën e datës 11.02.2025, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe ka kërkuar që të detyrohen të paditurit 1. Republika e Kosovës dhe 2. Qeveria e Republikës, që në mënyrë solidare, paditësve të ua kompensojnë shumat si në vijim: 1. paditësit të parë “MaxCapital” SH.A., në emër të shpronësimit të paligjshëm të licencës nr.37/2017, e datës 06.06.2017, për ushtrimin e veprimtarisë “baste sportive”, t'ia kompensojnë dëmin material në formën e fitimit të munguar në lartësi prej 1,135,936.94 €, si dhe kamatën ligjore për periudhën nga data 10.05.2019 deri më datë 05.06.2021, në lartësi prej 304,338.67 € apo shumën e përgjithshme prej 1,440,275.61 €, ndërsa pas datës 05.06.2021, t'ia paguaj kamatën ligjore prej 8% në vit, e llogaritur në lartësinë e dëmit prej 1,135,936.94 €, deri në pagesën definitive; 2. paditësit të dytë “Science Soft” SH.P.K., në emër të shpronësimit të paligjshëm të licencës nr.24/2017, e datës 02.11.2017, për ushtrimin e veprimtarisë “baste sportive”, t'ia kompensojnë dëmin material në formën e fitimit të munguar në lartësi prej 1,437,502.24 €, si dhe kamatën ligjore të llogaritur për periudhën nga data 10.05.2019 deri më datë 05.06.2021, në lartësi prej 366,083.90 €, apo shumën e përgjithshme prej 1,803,586.14 €, ndërsa pas datës 05.06.2021, t'ia paguaj kamatën ligjore prej 8% në vit, e llogaritur në lartësinë e dëmit 1,437,502.24 €, deri në pagesën definitive dhe 3. paditësit të tretë “Club Gold” SH.P.K., në emër të shpronësimit të paligjshëm të licencës nr.04/2018, e datës 27.09.2018, për ushtrimin e veprimtarisë “automateve në klube të veçanta”, t'ia kompensojnë dëmin material në formën e fitimit të munguar në lartësi prej 33,866,499.80 €, si dhe kamatën ligjore të llogaritur për periudhën nga data 10.05.2019 e deri më datë 26.09.2022, në lartësi prej 5,701,001.00 €, apo shumën e përgjithshme prej 39,567,500.00 €, ndërsa pas datës 26.09.2022, t'ia paguaj kamatën ligjore prej 8% në vit e llogaritur në lartësinë e dëmit 33,866,499.80 €, deri në pagesën definitive, si dhe të detyrohen të paditurit që paditësit të parë MaxCapital” SH.A., t'ia kompensojnë shpenzimet e procedurës kontestimore.

Pretendimet e paditësit

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë kërkesave dhe pretendimeve si në padi, paditësve i është shkaktuar dëm real dhe fitim i munguar për shkak të privimit arbitrar të pronësisë, gjegjësisht revokimit të licencave dhe mbylljes së veprimtarisë ekonomike si rezultat

i miratimit të Ligjit Nr.06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit. Ka deklaruar se ndalimi i menjëhershëm i aktivitetit pa paralajmërim dhe pa kompensim të përshtatshëm është cenim i të drejtës në pronë, të mbrojtur me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 119 të Kushtetutës. Ka shtuar se Gjykata Kushtetuese e Kosovës me Aktgjykimin numër AGJ.nr.2139/23 (KI185/21) të datës 13.03.2023, me parashtrues “CO Colina” SH.P.K., me të cilin konfirmohet se qasja për ushtrimin e veprimtarisë përfshirë edhe atë të lojërave të fatit është pronë, ndërsa privimi nga licenca pa kompensim adekuat nënkupton shkelje të së drejtës në pronë të mbrojtur me Kushtetutë dhe protokollin 1 të KEDNJ.

Tutje ka shtuar se shpronësimi i licencave të paditësve nuk përmbush të paktën dy kushtet e parapara: ligjshmërinë dhe proporcionalitetin. Sa i përket kushtit të ligjshmërisë ka deklaruar se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ, privimi nga gëzimi paqësor i pronës duhet fillimisht të plotësoj kushtin e ligjshmërisë, që nënkupton se duhet të parashihet në ligj. Megjithatë, kushti i ligjshmërisë nuk do të plotësohet, nëse ligji përkatës që kufizon të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë, nuk përmban disa elemente kualitative dhe nuk ofron procedura të caktuara mbrojtëse ndaj ndërhyrjeve arbitrare. Ka shtuar se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, parimi i ligjshmërisë kërkon që baza ligjore të jetë e qasshme, mjaftueshëm e saktë dhe e parashikueshme, ndërsa ligji për ndalimin e lojërave të fatit, nuk parashikon asnjë mënyrë për dëmshpërblimin e paditësve, qoftë sa i përket dëmit faktik të shkaktuar, fitimin e munguar, por as edhe një plan të vetëm minimizimi të ndikimit që ky ligj do të kishte te punëmarrësit e paditësve. Ka deklaruar se ligji nuk përmban as kushtin e parashikueshmërisë, sepse nisur nga miratimi i Koncept Dokumentit për lojërat e fatit dhe programit legjislativ të qeverisë për vitin 2019, ku parashihej hartimi i ligjit të ri për lojërat e fatit, pritshmëritë e paditësve ishin që veprimtaria e lojërave të fatit do të vazhdonte normalisht dhe për më tepër, do të krijoheshin lehtësira dhe do të përmirësohej klima e biznesit. Ndërsa në kundërshtim me këto pritshmëri dhe investimet e reja që paditësit do të ndërmerrnin, në mënyrë krejt të papritur dhe të pa paralajmëruar u njoftua mbyllja arbitrare e këtyre aktiviteteve, pa asnjë lloj periudhe tranzitore për këtë mbyllje.

Sa i përket kushtit të proporcionalitetit ka deklaruar se ndërhyrja në gëzim paqësor të pasurisë, duhet të krijoj një ekuilibër të drejtë në mes të nevojave të interesit të përgjithshëm të shoqërisë dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individëve, në veçanti duhet të jetë një lidhje e arsyeshme në mes të mjetit të përzgjedhur dhe qëllimit që kërkohet të arrihet përmes masës që e privon individin nga pasuria e tij dhe nëse një barrë e tepërt është vënë mbi

individin, atëherë ndërhyrja konsiderohet si jo proporcionale dhe do të ishte në shkelje të nenit 1 të Protokollit 1. Ka shtuar se nga argumentet e theksuara mund të konkludohet se ligji ndalimin e lojërave të fatit, nuk parasheh kompensim adekuat për të drejtat nga të cilat privohen paditësit, mungon periudha e përshtatshme kalimtare, procesi vendim marrës është qartësisht në kundërshtim me të gjitha kushtet për të qenë proces i drejtë dhe i paanshëm, si dhe janë shkelur pritshmëritë e ligjshme të paditësve për vijimin e aktivitetit.

Më tej ka deklaruar se Ligji për ndalimin e lojërave të fatit, përveç që është në kundërshtim me Kushtetutën dhe konventat tjera të aplikueshme drejtpërdrejtë në Kosovë, është në kundërshtim edhe me Ligjin Nr.04/L-220, për investimet e huaja, përkatësisht nenin 3 të këtij ligji i cili siguron dhe ofron mbrojtje për investitorët e huaj, si dhe nenin 6 të këtij ligji, ku parashihen detyrimet e Republikës së Kosovës dhe qeverisë së saj për garantimin e stabilitetit për investimet e huaja dhe mos dëmtimi i investitorëve të huaj përmes miratimit të çfarëdo ligji, rregullore ose akti normativ. Ndërsa neni 7 i po të njëjtit ligj përcakton se shpronësimi mund të bëhet vetëm pas plotësimit në mënyrë kumulative të këtyre kushteve: interesi i përgjithshëm publik, kompensimi i menjëhershëm, i përshtatshëm dhe efektiv.

Ka deklaruar se si pasojë e ndalimit të lojërave të fatit dhe revokimit të licencave të paditësve pas asnjë paralajmërim apo procedurë paraprake, paditësve u është shkaktuar dëm jashtëzakonisht i madh, dhe duke marrë parasysh praktikën e GJEDNJ për raste të ngjashme, të njëjti duhet të kompensohen përtej afatit të vlefshmërisë së licencave ekzistuese. Kjo për shkak se politika e Republikës së Kosovës, deri para miratimit të këtij ligji, sugjeronte që nuk do të kishte asnjë lloj pengese për shoqëritë e lojërave të fatit dhe në këtë mënyrë edhe pritshmëritë dhe investimet e paditësve merrnin për bazë rinovimin e licencës dhe ushtrimin e aktivitetit edhe për disa vite. Andaj si rrjedhojë kompensimi duhet të shtrihet edhe përtej skadimit të afatit të licencës, sepse palët kanë pasur pritshmëri të ligjshme që veprimtaria e tyre ekonomike do të vazhdojë pa pengesa dhe që licencat do të ripërtërihen.

Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësve, për kompensimin e dëmit në formën e fitimit të munguar si pasojë e mbylljes së menjëhershme të të gjitha pikave ku paditësit ushtronin aktivitetin e tyre dhe ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së lojërave të fatit, ndërsa sa i përket paditësit të tretë Club Gold, si bazë për përlllogaritjen e fitimit të munguar të merret Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera e nxjerra nga Administrata Tatimore e Kosovës. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Kundërshtimet e të paditurit

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurve me përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë përgjigjes në padi duke kundërshtuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve. Ka shtuar se një ndër prioritetet kryesore të të paditurit është forcimi dhe ruajtja e sigurisë publike, si dhe duke pas parasysh se deri te vendimi për ndalimin e lojërave të fatit kishte ardhur pasi që disa prej këtyre lokaleve në atë kohë ishin shndërruar në arenë krimi në të cilat edhe u morën jetë njerëzish, miratimi i ligjit për ndalimin e lojërave të fatit ka qenë një veprim i domosdoshëm. Ka kundërshtuar edhe lartësinë e kërkesëpadisë pasi që paditësit me asnjë prove të vetme nuk e kanë vërtetuar dëmin si fitim të humbur e cila është një rrethanë e ardhshme e pa sigurt e cila domosdo duhet të vërtetohet me prova të sigurta, aq më tepër kur Ligji për ndalimin e lojërave të fatit është miratuar me datë 28.03.2019 ndërkaq Licencat e paditësve ishin me afatshmëri, përkatësisht ishin të vlefshme vetëm deri me datë 05.06.2019 për paditësin e parë, 01.11.2019 për paditësin e dytë dhe po ashtu edhe për paditësin e trete deri me datë 01.11.2019, e jo deri në vitin 2021 siç pretendojnë paditësit. Pas pranimi të njoftimeve zyrtare nga ATK për pezullimin e licencave, asnjëri nga paditësit nuk kanë shprehur ndonjë pakënaqësi, më saktësisht për pezullimin e licencave të cilat paditësit i konsiderojnë si shpronësim të paligjshëm të licencave dhe nuk kanë kërkuar as anulimin e tyre në procedurë administrative.

Ka shtuar se Projektligji i miratuar në Qeveri ka paraparë ndalimin e lojërave të fatit me përjashtim të Lotarisë së Kosovës e cila është subjekt juridik publik, mirëpo me datë 28.03.2019, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin Nr.06/L-155 me të cilin ndalohen dhe mbyllen të gjitha lojërat e fatit në tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë këtu edhe Lotarinë e Kosovës. Kjo për shkak se lojërat e fatit më shumë se zgjidhje e problemeve ekonomike dhe mirëqenies së qytetarëve, kanë shkaktuar probleme për familjen e tyre dhe shoqërinë në përgjithësi, andaj i padituri ka konsideruar se mbyllja e tyre ka qenë një hap thelbësor në luftimin e kriminalitetit dhe forcimin e sigurisë juridike. Ka deklaruar se kërkesës së paditësve për kompensimin e dëmit edhe për dy vite pas përfundimit të afatit të licencës i mungon baza ligjore, për faktin se me asnjë dispozitë ligjore nuk është e garantuar e drejta e vazhdimi të licencës edhe për dy vite me automatizëm. Gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave, kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, duke marrë parasysh se mbyllja e kazinove dhe lokacioneve të lojërave të fatit kishte për qëllim uljen e krimit.

Administrimi dhe vlerësimi i provave

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor publik ka bërë administrimin e të gjitha provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse dhe atë: Licenca me numër 37/2017 e datës 06.06.2017, e lëshuar nga ATK; Vendimet e ATK-së për leje të zhvillimit të bizneseve si vijon, në lidhje me paditësin e parë: Vendimi numër 37/2017 e datës 26.12.2019 – Gjakovë, rruga “Kasim Uka”, Vendimi numër 37/2017 e datës 26.12.2019 – Gjilan, Fshati Përlepnice; Vendimi numër 37/2017 e datës 26.12.2019 – Prizren, rruga “Flamuri”, Vendimi numër 37/2017 e datës 26.12.2019 – Prishtinë, rruga “Haxhi Zeka”; Vendimi numër 13-06-047 e datës 07.03.2018 – Fushë Kosovë, Fshati Vragoli; Vendimi numër 13-06-298 e datës 27.02.2018 – Fushë Kosovë, Fshati Bardhi i Madh; Vendimi numër 13-06-2454 e datës 27.02.2018, -Prishtinë, Rruga “Vëllezërit Fazliu”; Vendimi numër 13-06-298 e datës 27.02.2018 – Prishtinë, rruga “Skenderbeu”; Vendimi numër 13-06-298 e datës 15.03.2018 – Klinë, rruga “Elena Gjika”; Vendimi numër 13-07-127 e datës 23.03.2018 – Klinë, Fshati Gralleve; Vendimi numër 13-06-189 e datës 30.04.2018 – Malishevë, rruga “Rilindja Kombëtare”; Vendimi numër 13-06-267 e datës 06.06.2018 – Gjilan, Fshati Dardani; Vendimi numër 13-06-254 e datës 06.06.2018 – Gjilan, rruga “Vëllezërit Frashëri”; Vendimi numër 13-06-268 e datës 27.06.2018 – Ferizaj, rruga “Cen Dugolli”; Vendimi numër 13-07-449 e datës 26.12.2018 – Skenderaj, rruga “Skenderbeu”; Vendimi numër 13-07-689 e datës 26.12.2018 – Gjilan, rruga “Nëna Terezë”; Licenca me numër 24/2017 e datës 02.11.2017, e lëshuar nga ATK për “ECCOBET” SH.P.K.; Vendimet e ATK-së për leje të zhvillimit të bizneseve si vijon, në lidhje me dhënien e lejeve të bizneseve për paditësin e dytë, si vijon: Vendimi numër ref.13-06-4266 e datës 27.12.2017 – Gjilan, rruga “Mulla Idrizi”, Vendimi numër ref.13-06-321 e datës 03.04.2018 – Prishtinë, rruga “Haxhi Zeka”, Vendimi numër ref.13-06-4357 e datës 12.02.2018 – Suharekë, rruga “Kadri Kokullari (Haxhi Zeka), Vendimi numër ref.13-07-277 e datës 17.08.2018 – Gjilan, rruga e Prishtinës, Vendimi numër ref.13-07-419 e datës 13.11.2018 – Gjakovë, rruga “Lekë Dukagjini”, Vendimi numër ref.13-07-111 e datës 17.05.2018 – Pejë, rruga “Selman Lajqi”, Vendimi numër ref.13-07-418 e datës 05.11.2018 – Prishtinë, Fshati Tereshdoll, Vendimi numër ref.13-07-346 e datës 24.07.2018 – Prishtinë, rruga “Dervish Rozhaja”, Vendimi numër ref.13-06-4654 e datës 12.02.2018 – Junik, Lagja Qeste “Agim Quni”, Vendimi numër ref.13-06-4262 e datës 17.08.2018 – Podujevë, Magjistratja Prishtinë – Podujevë; Licenca me numër 04/2018 e datës 27.09.2018 dhe Vendimi numër 02/2019 e datës 16.01.2019 për ushtrimin e lojërave të fatit në automate në klube të veçanta; Ekstraktet nga Regjistri i ARBK-së për paditësin e parë, për

paditësin e dytë dhe paditësin e tretë; Vendimi i Qeverisë numër 12/79 i datës 11.12.2018 dhe Koncept Dokumenti për lojërat e fatit; Programi legjislativ për vitin 2019 i Qeverisë së RKS; Vlerësimi i fitimit të munguar nga ndryshimet në legjislacion pas datës 15.05.2019 – Analiza Financiare e Deloitte Albania SH.P.K. përgatitur për paditësin e parë – Nëntor 2019; Vlerësimi i fitimit të munguar nga ndryshimet në legjislacion pas datës 15.05.2019 – Analiza Financiare e Deloitte Albania SH.P.K. përgatitur për paditësin e dytë – Nëntor 2019; Vlerësimi i fitimit të munguar nga ndryshimet në legjislacion pas datës 15.05.2019 – Analiza Financiare e Deloitte Albania SH.P.K. përgatitur për paditësin e tretë– Nëntor 2019; Materiali lidhur me vendimin e Qeverisë me numër 02/95 të datës 26.03.2019, ku përfshihen: Shkresa me numër protokolli 928/6 të datës 27.03.2019 me titull “Procedimi i projektligjit në Kuvendin e Kosovës” në tri gjuhë shqip, anglisht dhe serbe; Shkresa e Kryeministrit të atëhershëm z. Ramush Haradinaj në tri gjuhët zyrtare; Shkresa me numër protokolli 928/5 e datës 26.03.2019 me titull “Rekomandim për aprovimin e projektligjit për ndalimin e lojërave të fatit” në tri gjuhët zyrtare ; Vendimi numër 02/95 i datës 26.03.2019; Certifikata e përputhshmërisë procedurale për projektligjin për ndalimin e lojërave të fatit me numër 58/19 e datës 26.03.2019 në tri gjuhët zyrtare; Projektligji për ndalimin e lojërave të fatit; Memorandumi shpjegues i projektligjit për ndalimin e lojërave të fatit; Shkresa përcjellëse me numër 928/3 e datës 26.03.2019 në tri gjuhët zyrtare; Deklarata e përputhshmërisë së legjislacionit të RKS të ACQUIS të BE-së; Opinioni ligjor i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së i datës 25.03.2019 në tri gjuhët zyrtare; Opinioni i Departamentit të Buxhetit – Ministria e Financave me numër ref.37 i datës 26.03.2019 në tri gjuhët zyrtare; Transkripti i mbledhjes së Qeverisë në lidhje me pikën 3 të rendit të ditës; Njoftimi mbi revokimin e licencës numër 37/2017 i datës 02.05.2019; Njoftimi mbi revokimin e licencës numër 04/2018 i datës 02.05.2019; Njoftimi mbi revokimin e licencës numër 24/2017 i datës 02.05.2019; Komunikimet elektronike ndërmjet ATK-së dhe Avokaturës Shtetërore të datës 12.11.2024, 06.01.2025 dhe 10.01.2025; Ekspertiza Financiare Prill 2024 dhe 2 plotësimet e ekspertizës financiare të datës 08.01.2025 dhe 31.01.2025, të punuara nga eksperti financiar Lekë Musa.

Deklarimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se:

Nga deklarimet e palëve ndërgjyqëse dhe shkresat e lëndës rezulton se për asnjërën palë ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit kishin qenë të pajisur me licencë dhe leje për

ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit, të lëshuar nga Ministria e Financave, Administrata Tatimore e Kosovës. Po ashtu në rastin konkret nuk ishte kontestues as fakti se këto licenca ishin revokuar me datë 10.05.2019, si pasojë e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të fatit.

Në rastin konkret kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte nëse paditësve u takon e drejta për kompensimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e revokimit të licencave, respektivisht nëse i padituri është përgjegjës për kompensimin e dëmit.

Për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me çështjet kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse, gjykata iu referua provave si në vijim:

Nga Licenca me numër 37/2017 e datës 06.06.2017, e lëshuar nga ATK, rezulton se biznesi “Lloto Sport” SH.A. (MaxCapital” SH.A.), me numër fiskal 600371083, ka qenë i pajisur me licencë për “baste sportive” nga Ministria e Financave, Administrata Tatimore e Kosovës, me afat vlefshmërie deri më 05.06.2019.

Nga Vendimet e ATK-së për leje të zhvillimit të bizneseve në lidhje me paditësin e parë MaxCapital” SH.A.: Vendimi numër 37/2017 i datës 26.12.2019 – Gjakovë, rruga “Kasim Uka”, Vendimi numër 37/2017 i datës 26.12.2019, Gjilan, Fshati Përlepnice; Vendimi numër 37/2017 i datës 26.12.2019, Prizren, rruga “Flamuri”, Vendimi numër 37/2017 i datës 26.12.2019, Prishtinë, rruga “Haxhi Zeka”; Vendimi numër 13-06-047 i datës 07.03.2018, Fushë Kosovë, Fshati Vragoli; Vendimi numër 13-06-298 i datës 27.02.2018, Fushë Kosovë, Fshati Bardhi i Madh; Vendimi numër 13-06-2454 i datës 27.02.2018, Prishtinë, Rruga “Vëllezërit Fazliu”; Vendimi numër 13-06-298 i datës 27.02.2018, Prishtinë, rruga “Skenderbeu”; Vendimi numër 13-06-298 e datës 15.03.2018, Klinë, rruga “Elena Gjika”; Vendimi numër 13-07-127 i datës 23.03.2018, Klinë, Fshati Gralleve; Vendimi numër 13-06-189 i datës 30.04.2018, Malishevë, rruga “Rilindja Kombëtare”; Vendimi numër 13-06-267 i datës 06.06.2018, Gjilan, Fshati Dardani; Vendimi numër 13-06-254 i datës 06.06.2018, Gjilan, rruga “Vëllezërit Frashëri”; Vendimi numër 13-06-268 i datës 27.06.2018, Ferizaj, rruga “Cen Dugolli”; Vendimi numër 13-07-449 i datës 26.12.2018, Skenderaj, rruga “Skenderbeu”; Vendimi numër 13-07-689 i datës 26.12.2018, Gjilan, rruga “Nëna Terezë”, rezulton se nga Ministria e Financave, Administrata Tatimore e Kosovës, subjekti “Lottosport” SH.A., është pajisur me leje për ushtrimin e

veprimtarisë së lojërave të fatit në bast për lokacionet e sipërcekura, me afat vlefshmërie deri me datë 05.06.2019.

Nga Licenca me numër 24/2017 e datës 02.11.2017, e lëshuar nga ATK, rezulton se biznesi “ECCOBET” SH.P.K. (“Science Soft” SH.P.K.), me numër fiskal 601725809, ka qenë i pajisur me licencë për “baste sportive” nga Ministria e Financave, Administrata Tatimore e Kosovës, me afat vlefshmërie deri më 01.11.2019.

Nga Vendimet e ATK-së për leje të zhvillimit të bizneseve në lidhje me paditësin e dytë “Science Soft” SH.P.K.: Vendimi numër ref.13-06-4266 i datës 27.12.2017, Gjilan, rruga “Mulla Idrizi”, Vendimi numër ref.13-06-321 i datës 03.04.2018, Prishtinë, rruga “Haxhi Zeka”, Vendimi numër ref.13-06-4357 i datës 12.02.2018, Suharekë, rruga “Kadri Kokullari (Haxhi Zeka), Vendimi numër ref.13-07-277 i datës 17.08.2018, Gjilan, rruga e Prishtinës, Vendimi numër ref.13-07-419 i datës 13.11.2018, Gjakovë, rruga “Lekë Dukagjini”, Vendimi numër ref.13-07-111 i datës 17.05.2018, Pejë, rruga “Selman Lajqi”, Vendimi numër ref.13-07-418 i datës 05.11.2018, Prishtinë, Fshati Tereshdoll, Vendimi numër ref.13-07-346 i datës 24.07.2018, Prishtinë, rruga “Dervish Rozhaja”, Vendimi numër ref.13-06-4654 i datës 12.02.2018, Junik, Lagja Qeste “Agim Quni”, Vendimi numër ref.13-06-4262 i datës 17.08.2018, Podujevë, Magjistratja Prishtinë-Podujevë, rezulton se nga Ministria e Financave, Administrata Tatimore e Kosovës, subjekti “ECCOBET” SH.P.K., është pajisur me leje për ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit në bast për lokacionet e sipërcekura, me afat vlefshmërie deri me datë 01.11.2019.

Nga Licenca me numër 04/2018 e datës 27.09.2018, e lëshuar nga ATK, rezulton se biznesi “CLUB GOLD” SH.P.K., me numër fiskal 810083767, ka qenë i pajisur me licencë për “automate në klube të veçanta” nga Ministria e Financave, Administrata Tatimore e Kosovës, me afat vlefshmërie deri më 26.09.2020.

Nga Vendimi numër 02/2019 i datës 16.01.2019 për ushtrimin e lojërave të fatit në automate në klube të veçanta, rezulton se nga Ministria e Financave, Administrata Tatimore e Kosovës, subjekti “CLUB GOLD” SH.P.K., është pajisur me leje për ushtrimin e lojërave të fatit në “automate në klube të veçanta” për lokacionet Gjilan, Fushë Kosovë dhe Vushtrri, me afat vlefshmërie deri me datë 26.09.2020.

Nga Ekstraktet nga Regjistri i ARBK-së, rezulton se paditësi i parë “MaxCapital” SH.A. (Lottosport SH.A.), është regjistruar pranë ARBK-së, me datë 06.01.2010; paditësi dytë “Science Soft” SH.P.K. (ECCOBET SH.P.K.), është regjistruar pranë ARBK-së, me datë 04.01.2017, me aktivitet kryesorë “lojërat e fatit dhe basteve” dhe paditësi i tretë “Club Gold”, është regjistruar pranë ARBK-së, me datë 11.01.2018, me aktivitet primar “lojërat e fatit dhe basteve”.

Nga Vendimi i Qeverisë numër 12/79 i datës 11.12.2018, Koncept Dokumenti për lojërat e fatit dhe Programi legjislativ për vitin 2019 i Qeverisë së RKS, rezulton se projektligji për lojërat e fatit ka qenë i përfshirë në programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2019, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr.03/81 të datës 24.12.2018. Ndërsa me Vendimin nr.12/79 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është aprovuar Koncept Dokumenti për Lojërat e Fatit.

Nga Shkresa me numër protokolli 928/6 të datës 27.03.2019 me titull “Procedimi i projektligjit në Kuvendin e Kosovës” dhe Shkresa e Kryeministrit të atëhershëm z. Ramush Haradinaj, rezulton se nga Zyra e Kryeministrit ZKM, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, është proceduar Projektligji për Ndalimin e Lojërave të Fatit, për aprovim.

Nga Shkresa me numër protokolli 928/5 e datës 26.03.2019 me titull “Rekomandim për aprovimin e projektligjit për ndalimin e lojërave të fatit”, rezulton se Kryeministrit të Republikës së Kosovës i është rekomanduar aprovimi i Projektligjit për Ndalimin e Lojërave të Fatit.

Nga Vendimi numër 02/95 i datës 26.03.2019, rezulton se nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, është aprovuar Projektligji për Ndalimin e Lojërave të Fatit.

Nga Certifikata e përputhshmërisë procedurale për projektligjin për ndalimin e lojërave të fatit me numër 58/19 e datës 26.03.2019, rezulton se nga Zyra e Kryeministrit është deklaruar se Projektligji për Ndalimin e Lojërave të Fatit nuk ka kaluar disa faza procedurale të parashikuara nga Rregullorja e Punës së Qeverisë.

Nga Projektligji për ndalimin e lojërave të fatit, rezulton se me të njëjtin janë ndaluar të gjitha lojërat e fatit me përjashtim të Lotarisë së Kosovës dhe është shfuqizuar Ligji Nr.04/L-80 për Lojërat e Fatit.

Nga Transkripti i mbledhjes së Qeverisë, rezulton se është shqyrtuar Projektligji për Ndalimin e lojërave të fatit dhe i njëjti është aprovuar gjatë këtij takimi.

Nga Njoftimi mbi revokimin e licencës numër 37/2017 i datës 02.05.2019; Njoftimi mbi revokimin e licencës numër 24/2017 i datës 02.05.2019 dhe Njoftimi mbi revokimin e licencës numër 04/2018 i datës 02.05.2019, rezulton se paditësit 1. “MaxCapital” SH.A. (Lotto Sport SH.A.), 2. “Science Soft” SH.P.K. (ECCOBET SH.P.K.), 3. “Club Gold” SH.P.K., janë njoftuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, Drejtoria e Lojërave të Fatit, për revokimin e licencës për ushtrimin e aktiviteteve të lojërave të fatit, nga data 10.05.2019, për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të fatit.

Nga Komunikimet elektronike ndërmjet ATK-së dhe Avokaturës Shtetërore të datës 12.11.2024, 06.01.2025 dhe 10.01.2025, rezulton se nga ATK është njoftuar se asnjë biznes nuk ka paraqitur ankesë lidhur me revokimin e licencave.

Në Ekspertizën Financiare të punuar nga eksperti financiar Lekë Musa, prill 2024, është konstatuar se fitimi i humbur për paditësin e parë “MaxCapital” SH.A., për periudhën prej datës 10.05.2019 deri më datë 05.06.2021, është në vlerë prej 1,135,936.94 €, ndërsa interesi në shumën prej 304,338.67 €, në shumën totale prej 1,440,275.61 €; për paditësin e dytë “Science Soft” SH.P.K., për periudhën prej datës 10.05.2019 deri më datë 01.11.2021, në vlerë prej 1,437,502.24 €, ndërsa interesi në shumën prej 366,083.90 €, në shumën totale prej 1,803,586.14 €; për paditësin e tretë “Club Gold” SH.P.K., për periudhën prej datës 10.05.2019 deri me datë 26.09.2022, në vlerë prej 2,680,743.66 €, ndërsa interesi në shumën prej 566,977.46 €, në shumën totale prej 3,267,721.11 €.

Në plotësimin e ekspertizës financiare të datës 08.01.2025, është konstatuar se fitimi i humbur për paditësin e parë “MaxCapital” SH.A., për periudhën prej datës 10.05.2019 deri më datë 05.06.2019, është në vlerë prej 37,641.81 €, ndërsa interesi në shumën prej 12,798.22 €, në shumën totale prej 50,440.22 €; për paditësin e dytë “Science Soft” SH.P.K., për periudhën prej datës 10.05.2019 deri më datë 01.11.2019, në vlerë prej 287,500.45 €, ndërsa interesi në shumën prej 97,750.15 €, në shumën totale prej 385,250.60 €, ndërsa për paditësin e tretë “Club Gold” SH.P.K., ka konstatuar se i njëjti është subjekt i një procedure kontrolli nga Administrata Tatimore e Kosovës, ku është vlerësuar me qarkullim dhe tatim shtesë për vitin 2020, andaj

meqenëse e njëjta nuk është përfunduar, analiza financiare mund të bëhet pas përfundimit të procedurës nga ATK.

Në plotësimin e ekspertizës financiare të datës 31.01.2025, është konstatuar se fitimi i munguar i llogaritur sipas deklarimeve të paditësit “Club Gold” SH.P.K., për periudhën prej datës 10.05.2019 deri më datë 26.09.2020, është në vlerë prej 1,086,608.83 €, ndërsa interesi në shumën prej 332,162.97 €, në shumën totale prej 1,418,771.30 €, ndërsa për periudhën deri më shtator 2022, në vlerë prej 1,594,136.00 € dhe interesi në shumën prej 325,344.00 €, në shumën totale prej 1,919,480.00 €. Fitimi i humbur i kalkuluar sipas vlerësimeve të ATK-së, për periudhën prej datës 10.05.2019 deri më datë 26.09.2020, është në vlerë prej 24,136,579.00 €, ndërsa interesi në shumën prej 7,609,522.00 €, në shumën totale prej 31,746,101.00 €, ndërsa për periudhën deri më shtator 2022, në vlerë prej 33,866,499.00 € dhe interesi në shumën prej 5,701,001.00 €, në shumën totale prej 39,567,500.00 €.

Vendimi i gjykatës dhe Baza ligjore

Në kontekstin e përgjithshëm të procedurës provuese, duke vlerësuar pretendimet e të autorizuarit të paditësve dhe kundërshtimet e të autorizuarit të paditurit, lidhur me bazueshmërinë e kërkesëpadisë, gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, andaj të njëjtën e ka aprovuar pjesërisht dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, si në vijim:

Nga provat e administruara gjykata ka gjetur se paditësi “MaxCapital” SH.A. (“Lloto Sport” SH.A.) ka qenë i pajisur me licencë për “baste sportive” nga data 06.06.2017, e vlefshme deri më datë 05.06.2019. Nga Vendimet e ATK-së vërtetohet se i njëjti ka qenë i pajisur me leje për ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit në bast për lokacionet: Gjakovë një pikë, Gjilan katër pika, Prizren një pikë, Prishtinë tri pika, Fushë Kosovë dy pika, Klinë dy pika, Malishevë një pikë, Ferizaj një pikë dhe Skenderaj një pikë. Paditësi i dytë “Sciente Soft” SH.P.K. (“ECCOBET” SH.P.K.), ka qenë i pajisur me licencë për “baste sportive” nga data 02.11.2017, e vlefshme deri më datë 01.11.2019. Nga vendimet e ATK-së vërtetohet se i njëjti ka qenë i pajisur me leje për ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit në bast për lokacionet: Gjilan dy pika, Prishtinë tri pika, Suharekë një pikë, Gjakovë një pikë, Pejë një pikë, Junik një pikë dhe Podujevë një pikë. Paditësi i tretë “CLUB GOLD” SH.P.K., ka qenë i pajisur me licencë për “automate në klube të veçanta” nga data 27.09.2018, e vlefshme deri më datë 26.09.2020. Nga Vendimi i ATK-së vërtetohet se i njëjti ka qenë i pajisur me leje për ushtrimin e veprimtarisë së

lojërave të fatit në “automate në klube të veçanta” për lokacionet Gjilan, Fushë Kosovë dhe Vushtrri.

Projektligji për Ndalimin e Lojërave të Fatit me datë 26.03.2019, i është rekomanduar për aprovim Kryeministrit të Republikës së Kosovës, dhe i njëjti është aprovuar nga Kryeministri me Vendimin numër 02/95 të datës 26.03.2019, ndërsa me datë 27.03.2019, Projektligji është proceduar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për aprovim. Me 28 mars 2019, Kuvendi ka miratuar Ligjin Nr.06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit, me të cilin është shfuqizuar Ligji Nr. 04/L-080 për Lojërat e Fatit.

Me datë 02.05.2019, paditësit “MaxCapital” SH.A. (Lotto Sport SH.A.), “Science Soft” SH.P.K. (ECCOBET SH.P.K.), “Club Gold” SH.P.K., janë njoftuar nga ATK, Drejtoria e Lojërave të Fatit, për revokimin e licencës për ushtrimin e aktiviteteve të lojërave të fatit, nga data 10.05.2019, si pasojë e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji me datë 10.05.2019, janë mbyllur dhe janë ndaluar të gjitha lojërat e fatit në Republikën e Kosovës, dhe si rrjedhojë licenca e paditësve është revokuar dhe aktivitetet e tyre janë ndërprerë.

Për të vërtetuar bazueshmërinë e kërkesëpadisë të paditësve, gjykata paraprakisht vlerësoi nëse licenca përbën të drejtë pronësore dhe nëse revokimi i saj përbën cenim në gëzimin e lirë të pronës. Për ta vlerësuar këtë çështje, gjykata iu referua vlerësimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të dhëna në Aktgjykimin Nr. KI18S/21 datë 13.03.2023, për rast pothuajse identik, në të cilin Gjykata ka konstatuar si në vijim:

“...licenca e biznesit përbën "pronë" nga neni 46 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së; marrja ose heqja e licencave të vlefshme të biznesit përbën ndërhyrje në të drejtën për gëzim paqësor të pronës, të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1; me heqjen e licencës së vlefshme të punës ka pasur ndërhyrje në të drejtën e pronës, përkatësisht kontrollin e përdorimit të pronës, si rezultat i së cilës është ndaluar në mënyrë të menjëhershme ushtrimi i aktivitetit ekonomik duke u mbyllur veprimtaria biznesore; ndërhyrja në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës në këtë rast është bërë në bazë të ligjit; ndërhyrja në pronë, përkatësisht masa e kontrollit të shfrytëzimit të pronës ka qenë e menjëhershme, përmes së cilës kërkohej ndërprerja e veprimtarisë së biznesit dhe se nuk kishte masa të tjera alternative, pasi që pas hyrjes në fuqi të Ligjit, dhe si rrjedhojë Njoftimit të ATK-së si masë zbatuese, është detyruar të ndërpresë

aktivitetin e tij ekonomik me efekt të menjëhershëm, duke u përballur kësisoj me barrë të rëndë dhe jo-proporcionale; pavarësisht faktit se nuk ka pasur konfiskim të pronës, por vetëm një masë kontrolli të "pronësisë", me revokimin e licencës së vlefshme dhe lejes se punës, pësoi një zvogëlim të vlerës së pjesëve të pronës që nuk ishte përfshirë me masat, për shkak se të njëjtat e humben funksionin bazë që kishin sa ekzistonte licenca; ndërhyrja në të drejtën e gëzimit paqësor të "pronës", përveç që duhet të jetë e paraparë në ligj dhe në interes publik, duhet të rezultojë me "ekuilibër të drejtë" mes kërkesave të interesit publik të komunitetit dhe kërkesave për të mbrojtur të drejtat themelore të individit; marrja e pronës pa pagesën e një shume arsyeshëm të lidhur me vlerën e saj, zakonisht përbën ndërhyrje joproporcionale dhe mungesë të plotë të kompensimit dhe mund të konsiderohet e justifikueshme në baze të nenit 1 të Protokollit nr. 1, të KEDNJ-së vetëm në rrethana të jashtëzakonshme..."

Bazuar në interpretimet e sipërcituara, kjo gjykatë vlerëson se nuk është kontestuese se në rastin konkret ekziston bazueshmëria ligjore e kërkesëpadisë së paditësve, sepse nuk është kontestuese se licenca e biznesit përbën "pronë" nga neni 46 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së, se marrja ose heqja e licencave të vlefshme të biznesit përbën ndërhyrje në të drejtën për gëzim paqësor të pronës, të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 dhe se me heqjen e licencës së vlefshme të punës ka pasur ndërhyrje në të drejtën e pronës së paditësve, andaj i padituri me ndalimin e menjëhershëm të aktivitetit ekonomik, duke mbyllur veprimtarinë afariste të paditësve, ka shkelur të drejtat e tyre dhe njëkohësisht u ka shkaktuar dëm të cilin nuk e ka kompensuar.

Për më tepër gjykata vlerëson se masat e ndërmarra nga i padituri, duke u revokuar licencat dhe duke ndërprerë menjëherë aktivitetin afarist pa asnjë kompensim apo periudhe kalimtare, nuk kanë qenë proporcionale, sepse nuk është arritur një "ekuilibër i drejtë" ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit. Me këtë paditësve u janë shkelur të drejtat e garantuar me Kushtetutë dhe ligj, sepse të njëjtit kanë pasur pritje legjitime që gjatë periudhës për të cilën kanë pasur licencën dhe lejen e punës së vlefshme, do të mund të ushtronin aktivitetin e tyre ekonomik dhe do të realizonin të hyra.

Prandaj në rastin konkret rezulton si jokontestues fakti se, licencat e paditësve janë revokuar nga i padituri në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe ligjore, ndërsa paditësit përkundër faktit se kanë pësuar dëm pasuror për shkak të pamundësisë të zhvillimit të aktivitetit

afarist dhe realizimit të të hyrave që do t'i realizonin sikur të mos kishte ndërhyrje të të paditurit, të njëjtit nuk kanë pranuar asnjë lloj kompensimi për revokimin e licencave.

Andaj gjykata vlerëson se paditësve u është shkaktuar dëm, për të cilin u takon e drejta e kompensimit dhe për këtë iu referua Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili në nenin 136 par 1., përcakton se: *“Kush i shkaktën tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”*, dhe në nenin 137 përcakton se: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur)...”*

Ndërsa nenet 173 dhe 174 të LMD-së, parashohin se: *“I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur...Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmerret veprimin...”* dhe se *“...dëmi duhet të kompensohet në mënyrë të plotë ashtu që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim”*.

Bazuar në dispozitat e sipërcituara rezulton se, për ekzistimin e përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit duhet të përmbushen këto kushte: të ekzistoj dëmi, që dëmi të jetë shkaktuar me veprim ose lëshim të dëmtuesit, që të ekzistoj faji i dëmtuesit dhe lidhja shkakësore mes veprimit dëmtues dhe pasojave - dëmit. Megjithatë në rastin konkret, dëmi është shkaktuar me vendimet e të paditurit, gjykata vlerëson se ekziston lidhja e drejtpërdrejtë kauzale e veprimeve të paditurit me pasojat e shkaktuara tek paditësit, si rrjedhojë e të cilës paditësve u është shkaktuar dëm duke iu pamundësuar shtimi, përkatësisht rritja e pasurisë së tyre. Me revokimin e licencave gjatë kohës së vlefshmërisë së tyre, gjykata vlerëson se paditësve u është mohuar mundësia për të realizuar fitimin, që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave, dhe me këtë të njëjtëve u është shkaktuar dëmi në formën e fitimit të humbur, për të cilin u takon e drejta e kompensimit.

Andaj duke u mbështetur në këto dispozita dhe të thënat e cekura më lart, gjykata ka gjetur se është e bazuar kërkesa për kompensimin e dëmit real në formën e fitimit të munguar, në shumat e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sepse nga provat që gjenden në shkresat

të lëndës rezulton si jokontestuese se paditësit kanë pësuar dëm për shkak të veprimeve të padrejta të të paditurit.

Lartësinë e kompensimit adekuat, për periudhën në të cilën paditësit kishin licencë valide dhe leje për ushtrimin e veprimtarisë, gjykata e përcaktoi në bazë të ekspertizës financiare të punuar nga eksperti financiar Lekë Musa, prill 2024 dhe plotësimeve të datës 08.01.2025 dhe 31.01.2025, në të cilat eksperti ka konstatuar se fitimi i humbur për paditësin e parë “MaxCapital” SH.A., për periudhën prej datës 10.05.2019 deri më datë 05.06.2019, është në vlerë prej 37,641.81 €, për paditësin e dytë “Science Soft” SH.P.K., për periudhën prej datës 10.05.2019 deri më datë 01.11.2019, në vlerë prej 287,500.45 € dhe për paditësin e tretë “Club Gold” SH.P.K., për periudhën prej datës 10.05.2019 deri më datë 26.09.2020, është në vlerë prej 1,086,608.83 €. Ekspertizës financiare, përkatësisht plotësimeve të saj, gjykata ia fali besimin sepse konstatimet e ekspertit përputhen në tërësi edhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve për kompensimin e dëmit në formën e fitimit të munguar dhe atë: paditësit “MaxCapital” SH.A., për periudhën nga data 06.06.2019 deri më 05.06.2021, shumën prej 1,098,295.13 €; paditësit “Science Soft” SH.P.K., për periudhën nga data 02.11.2019 deri më 01.11.2021, shumën prej 1,150,001.79 €, dhe paditësit “Club Gold” SH.P.K., nga data 27.09.2020 deri më 26.09.2022, shumën prej 32,779,890.70 €. Gjykata vlerësoi si të pabazuara kërkesat e paditësve për kompensimin e dëmit në formën e fitimit të munguar për periudhat e lartcekura, për shkak se të njëjtit nuk posedonin licenca të vlefshme gjatë atyre periudhave. Licenca e paditësit të parë “MaxCapital” SH.A., kishte validitet deri me datë 05.06.2019, e paditësit të dytë “Science Soft” SH.P.K., deri me datë 01.11.2019, dhe e paditësit të tretë “Club Gold” SH.P.K., deri me datë 26.09.2020.

Duke marrë parasysh se, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Ndalimin e Lojërave të Fatit, licencat e paditësve për ushtrimin e aktivitetit të lojërave të fatit u revokuan dhe se kompensimi për periudhën kur ata kishin licencë u është njohur, gjykata ka vlerësuar se kërkesa për kompensimin e dëmit në formën e fitimit të munguar për periudhën pas afatit të vlefshmërisë së licencave, nuk ka bazë ligjore dhe se paditësve nuk u takon kompensimi për periudhën në të cilën nuk kishin licenca valide.

Gjykata po ashtu ka gjetur si të pabazuar kërkesën e paditësit “Club Gold” SH.P.K., për kalkulimin e fitimit të munguar që do të realizonte nëse nuk do të kishte ndërprerje të veprimtarisë, mbi bazën e raporteve të vlerësimit të ATK-së. Kjo nga shkak se ato raporte nuk janë përfundimtare, pasi janë të kontestuara në procedurë administrative dhe gjyqësore, dhe nuk mund të pranohen si prova valide mbi të cilat gjykata mund të mbështesë vendimin e saj. Për më tepër deklarimet e paditësit “Club Gold” SH.P.K., lidhur me qarkullimin e tij gjatë zhvillimit të aktivitetit afarist, të dorëzuara në ATK, përbëjnë deklarime zyrtare, ndërsa gjykata nuk mund të i njeh të drejta përtej deklarimeve të tij për të cilat ka paguar tatim. Kjo sepse edhe po të vërtetohej e kundërta, gjykata nuk do të mund të i njihte ndonjë të drejtë mbi ndonjë gjendje të kundërligjshme, respektivisht nuk do të mund të ia njihte fitimin e humbur të cilin pala nuk e ka deklaruar, respektivisht e ka fshehur, e çka në fakt do të përbënte veprim të kundërligjshëm.

Gjykata duke iu referuar nenit 382 të LMD-së, me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, detyroi të paditurin që përveç shumës në emër të kompensimit të dëmit në formën e fitimit të munguar, paditësve t’ua paguajë edhe kamatën ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 28.05.2020 e deri në pagesën definitive.

Gjykata ka refuzuar kërkesat e paditësve për shumat e kërkuara në emër të kamatës ligjore, mbi shumën dhe periudhën e aprovuar në pikën I të dispozitivit, përkatësisht: paditësit “MaxCapital” SH.A., kamatën ligjore në lartësi prej 304,338.67 €, paditësit “Science Soft” SH.P.K., kamatën ligjore në lartësi prej 366,083.90 € dhe paditësit “Club Gold” SH.P.K., kamatën ligjore në lartësi prej 5,701,001.00 €. Kjo për shkak se kërkesat për kamatën ligjore ishin paraqitur nga data e revokimit të licencës dhe kishin përfshirë edhe periudhën në të cilën paditësit nuk kishin licencë valide, periudhë për të cilën gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve. Gjykata vlerëson se për kamata për kërkesat e kompensimit të dëmit material (dëm i zakonshëm apo fitim i munguar) fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të kërkesës për kompensim. Në këtë rast kërkesa për kompensim është paraqitur me padi, atëherë kamata fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë. Andaj gjykata ka njohur kamatën ligjore në shkallën prej 8% nga data e paraqitjes së padisë, më datë 28.05.2020 e deri në pagesën definitive, siç është përcaktuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pa llogaritur shumën e kamatës sipas specifikimeve të paditësve, me qëllim të shmangies së konfuzionit në lidhje me lartësinë dhe periudhën e llogaritjes së saj.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim e të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi “MaxCapital” SH.A. dhe atë: për përfaqësimin në 5 seanca shumën prej 2,640.60 (5 x 528.12 €), për përpilimin e padisë shumën prej 487.50 €; për pagesën e ekspertizës financiare dhe plotësimit të saj shumën prej 1,400.00 €, si dhe për pagesën e taksës për padi shumën prej 1,000.00 €, në shumën e përgjithshme prej 5,528.10 €.

Nga arsyet e cekura më lart, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

Divizioni për Investitorët e Huaj

KI.nr.3/22, datë 04.03.2025

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.